

GJYKATA E APELIT
NË EMËR TË POPULLIT

Numri i lëndës: **PAKR 147/16**

Më: **4 gusht 2016**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese si dhe nga gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov dhe gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Noora Aarnio, si procesmbajtëse,

Në procedurën penale kundër

R.K:

I akuzuar në bazë të Aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës nr. PP. **103 / 2011**, të ngritur në gjykatë më 12 dhjetor 2014, për veprat në vijim:

- 1) **Vrasje e rëndë**, në kundërshtim me nenet 146 dhe 147 (4), (6), (8), dhe (10) të Kodit Penal të Kosovës (më tej në tekst “KPK”), në kuptim të nenit 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të vitit 2013 (më tej në tekst “KPRK”);
- 2) **Vrasje e rëndë në tentativë**, në kundërshtim me nenet 146 dhe 147, (4), (6), (8), dhe (10) të KPK-së, në kuptim të neneve 20 dhe 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së;
- 3) **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328 (1) dhe (2), në kuptim të nenit 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 374 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
- 4) **Pengim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare**, në kundërshtim me nenin 316 (1) dhe 3 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 409, (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
- 5) **Rrezikim i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme**, në kundërshtim me nenin 299 (1) të KPK-së, në kuptim të nenit 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;

- 6) **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm**, në kundërshtim me nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, në kuptim të nenit 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
- 7) **Pjesëmarrje në turmën e cila është duke kryer veprën penale**, në kundërshtim me nenin 320 (1) të KPK-së, në kuptim të nenit 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;

Të hedhur poshtë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, sa i përket akuzës për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, me vendimin P. Nr. 147/2014, të datës 17 prill 2015,

Të gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me Aktgjykimin P. Nr. 147/2014, të datës 10 dhjetor 2015 si më poshtë:

R.K është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale të ricilësuar si Pengim i personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare (pika 4), në kundërshtim me nenin 318 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25)¹, e cila aktualisht dënohet me nenin 409 (2) të KPRK-së, në kuptim të nenit 31 të KPRK-së.

R.K është shfajësuar për kryerjen e veprave penale të Vrasjes së rëndë (pika 1), Vrasjes së rëndë në tentativë (pika 2), Rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme (pika 5), Shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (pika 6), Pjesëmarrjes në turmën e cila është duke kryer veprën penale (pika 7), në bazë të nenit 364 (1.3) të Kodit të Procedurës Penale (më tej në tekst “KPP”), për shkak se sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore është konstatuar se nuk ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i njëjti i kishte kryer veprimet në fjalë.

R.K është dënuar me gjashtë (6) vjet burgim. Në pajtim me nenin 43 (1) dhe (2), dënimi shqiptohet me kusht gjatë një periudhe verifikuese prej dy vjetësh. Ai po ashtu urdhërohet ta paguajë shumën prej 200 eurosh si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale.

Duke vendosur rreth ankesës në vazhdim të parashtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. Nr. 147/2014, të datës 10 dhjetor 2015

- **Ankesës së prokurores së EULEX-it Neeta Amin, të paraqitur më 20 janar 2016,**

Pas shqyrtimit të përgjigjes së avokatit mbrojtës Miodrag Brkljač të parashtuar më 3 shkurt 2016;

¹ Kjo është ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-002 mbi plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës duke ia hequr fjalën “të Përkohshëm”

Pas mbajtjes së seancës publike të kolegjit të apelit më 3 gusht 2016;

Pas këshillimit dhe votimit më 4 gusht 2016;

Në pajtim me nenet 389, 390, 394 dhe 398 të KPP-së;

E merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e prokurores së EULEX-it dhe ndryshohet dënimi. R.K dënohet me një vit burgim në bazë të nenit 38 (1) dhe (2) të KPK-së. Dënimi është me kusht për tre vjet në përputhje me nenet 43 (2) dhe 44 (1) të KPK-së.**

- II. **Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës Nr. P 147/2014, i datës 10 dhjetor 2015 ndryshohet *ex officio* lidhur me emërtimin e veprës penale në përputhje me nenin 318 (1) të KPK-së. Emërtimi i saktë i saj është “Pjesëmarrje në grup në pengimin e personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”.**

- III. **Vërtetohet pjesa tjetër e Aktgjykimit.**

A R S Y E T I M

I. PROCEDURA E GJERTANISHME

Ngjarjet të cilat çuan deri tek rasti kriminal në fjalë kanë ndodhur më 26 korrik 2011, për afërsisht rreth orës 13:30 në zonën në mes të fshatrave Varage dhe Zupce, ku ishte përfshirë një kolonë e policëve të PK-së (Policisë së Kosovës), njëri prej të cilëve edhe ishte vrarë.

Përshkrimi i detajuar i procedurës deri në shpalljen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës mund të gjendet në Aktgjykimin e datës 10 dhjetor 2015.²

² Faqet 10 - 15

Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **R.K.** dhe mbrojtësit të tij Miodrag Brkljač më 12 janar 2016, ndërsa prokurorit të EULEX-it më 8 janar 2016. Më 20 janar 2016, prokurori i EULEX-it ka parashtruar ankesën kundër aktgjykimit në fjalë, ndërsa më 3 shkurt 2016, mbrojtësi i **R.K.** e ka parashtruar përgjigjen në ankesë.

Lënda i është kaluar për vendim mbi ankesën Gjykatës së Apelit më 3 mars 2016. Më 14 mars 2016 prokurori i shtetit i apelit e ka paraqitur propozimin.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më 3 gusht 2016 në praninë e prokurorit të apelit Agren, përfaqësuesit të palëve të dëmtuara, mbrojtësit Mira Delević (për **R.K.**) dhe Dobrica Lazić (për **S.S.**). Të pandehurit **R.K.** dhe **S.S.** janë ftuar me kohë për seancë siç dëshmohet edhe me fletë dërgesat në shkresat e lëndës, por nuk kanë marrë pjesë. Kanë munguar edhe palët e dëmtuara.

Kolegji i apelit është këshilluar dhe ka votuar më datën 4 gusht 2016.

I. PARASHTRESAT E PALËVE

Prokurorja e EULEX-it Neeta Amin më datën 20 janar 2016 ka parashtruar në Gjykatën Themelore ankesë të afatshme, e cila mban datën 15 janar 2016, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, neni 383 (1.1);
- Shkeljes së ligjit penal, neni 383 (1.2);
- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, neni 383 (1.3).

Prokurorja e EULEX-it pretendon se Gjykata Themelore ka gabuar në konstatimin e saj lidhur me dashjen e **R.K.** Ajo pretendon se përkundër faktit se **R.K.** ishte në dijeni rreth dashjes së tjerëve për t'i dëmtuar policët, ai prapë ka zgjedhur që të marrë pjesë në mënyrë aktive në bllokimin e rrugës, duke vepruar kështu në bashkëkryerje me të tjerët me qëllim të dëmtimit të policëve në fjalë.

Prokurorja e EULEX-it më tej pretendon se Gjykata Themelore ka gabuar kur e ka ricilësuar akuzën Pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 316 i KPK-së dhe neni 409 i KPRK-së). Ajo është e mendimit se veprimet e **R.K.** përbëjnë “dhunë apo kanosje për përdorim të atqasshëm të dhunës” (neni 316, paragrafi 1 i KPK-së) dhe “kanosje serioze” (neni 409, paragrafi 1 i KPRK-së).

Sa i përket akuzës “Rrezikim i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”, prokurorja e EULEX-it pretendon se për të ndodhur ‘rrezikimi’ mjafton që epilogu të parashikohet në

mënyrë të arsyeshme. Në këtë mënyrë Gjykata Themelore ka gabuar gjatë cilësimit juridik të veprës.

Sa i përket akuzës “Pjesëmarrje në turmën e cila është duke kryer veprën penale”, prokurorja e EULEX-it pohon se KPK-ja e përcakton qartë se çfarë përbën një turmë. Për më tepër, provat provojnë qartë se në barrikadë kanë qenë diku në mes 8 deri në 10 persona. Për këtë arsye, aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i gabueshëm në mënyrë të qartë si dhe paraqet interpretim të dobët të ligjit.

Sa i përket dënimit, prokurorja e EULEX-it deklaron se pranimi si rrethanë lehtësuese i kalimit të një kohe të gjatë, që ka ardhur si pasojë e fshehjes / arratisë së **R.K.** është në kundërshtim me nenin 74 të KPRK-së. Prandaj, arsyetimi i Gjykatës Themelore është i gabueshëm, me defekte dhe në kundërshtim me ligjin. Prokurorja e EULEX-it më tutje deklaron se Gjykata Themelore nuk i ka marrë parasysh ashtu si duhet dhe në mënyrë të arsyeshme rrethanat rënduese të “pranisë së dhunës së vërtetë apo kërcënimit me dhunë në kryerjen e veprës penale”, të “veprës penale që ka përfshirë viktima të shumta” dhe të “veprës penale të kryer kundër një personi apo grupi personash ... për shkak të përkatësisë etnike apo origjinës kombëtare, gjuhës, besimit fetar apo mungesës së besimit fetar, ... apo për shkak të lidhjes së tyre me personat që i kanë karakteristikat në fjalë” siç theksohet në nenin 74 (2.3), (2.5) dhe (2.12) të KPRK-së.

Në fund, prokurorja e EULEX-it është e mendimit se nuk ekzistojnë rrethana për të urdhëruar vetëm mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të procedurës. Prandaj, Gjykata Themelore e ka konstatuar gabimisht obligimin e mbulimit të shpenzimeve të procedurës.

Prokurorja e EULEX-it propozon që Aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje lidhur me të pandehurin **R.K.**

Përgjigjet në ankesë

Mbrojtësi i të akuzuarit **R.K.**, avokati Miodrag Brkljač, ka parashtruar përgjigje në ankesën e prokurores më datën 3 shkurt 2016. Ai konsideron se ankesa e prokurores është e pabazuar dhe propozon që ajo të refuzohet. Ai pretendon se prokurorja e EULEX-it nuk i ka shpjeguar në mënyrë të detajuar në ankesë shkeljet e pretenduara të procedurës (në përputhje me nenin 384 të KPP-së) dhe të ligjit material (në përputhje me nenin 385 të KPP-së). Ankesa ka qenë akoma më e paqartë sa i përket vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Mbrojtësi është i mendimit se Gjykata Themelore i ka vlerësuar provat në mënyrë të kujdesshme dhe të gjithanshme si dhe e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike.

Sa iu përket veprimeve të R.K në barrikadë, mbrojtësi e përsërit faktin që **R.K** thjesht e ka treguar gishtin e mesëm dhe ka bërë shenjë me duar nga kolona për t'u kthyer prapa. Ai është i mendimit se këto veprime nuk mund të konsiderohen si “kërcënuese”.

Mbrojtësi i të akuzuarit **S.S**, avokati Dobrica Lazić po ashtu ka dhënë përgjigje në ankesën e prokurorit më 26 janar 2016. Pasi që prokurori nuk e ka apeluar aktgjykimin lidhur me të, nuk ka nevojë të shpjegohet më tej përgjigjja.

Propozimi i prokurorit të apelit

Prokurori i apelit Lars Agren në propozimin e tij të datës 14 mars 2016 e mbështet ankesën e prokurorit. Prokurori i apelit e thekson se Gjykata Themelore nuk kishte arritur ta kuptonte lidhjen në mes të pjesëmarrjes së **R.K**. në barrikadë dhe vrasjes së policit E.Z . **R.K** ka vepruar në bashkëkryerje dhe në bazë të një plani të përbashkët. Barrikada të cilën ai e kishte ngritur në bashkëkryerje me të tjerët ka qenë faktor vendimtar në vrasjen e E.Z t dhe në vrasjet e rënda në tentativë.

Për më tepër, prokurori i apelit vëren se ngritja e barrikadës nga zalli dhe gurët përbënte rrezik konkret për jetën e njerëzve që vozisnin në rrugën në fjalë. Përfshirja e gjuajtjeve me armë në barrikadën e dytë e ka rrezikuar dhe më shumë jetën e njerëzve që po e shfrytëzonin rrugën në fjalë. **R.K** ka qenë bashkëkryerës në të dyja aktivitetet e përmendura.

Po ashtu, siç është përmendur edhe më herët, **R.K** duhet të mbahet përgjegjës edhe për gjuajtjet me armë e me këtë ai ka shkaktuar edhe rrezik të përgjithshëm për njerëzit.

Përveç kësaj, Gjykata Themelore ka gabuar kur ka konstatuar se kishte pasur më pak sesa tetë njerëz në turmën në barrikadë. Pasi që **R.K** duhet të mbahet përgjegjës për gjuajtjet nga armët, ai duhet të dënohet po ashtu edhe për Pjesëmarrje në turmën që kryen vepër penale.

Në fund, prokurori i apelit është i mendimit se koha e kaluar – janë mbushur katër vjet nga vepra penale në fjalë – nuk mund të merret si faktor lehtësues për shkak se kjo vonesë është shkaktuar si pasojë e sjelljes së tij. Për më tepër, Gjykata Themelore është dashur t'i konsiderojë faktorët rëndues të referuar në nenet 74 (2.3), (2.5) dhe (2.12) të KPRK-së.

Prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që ta pranojë ankesën, ta anulojë aktgjykimin e kontestuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore. Përndryshe, në seancën e Gjykatës së Apelit, prokurori i apelit i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin dhe t'i shpallë të pandehurit fajtorë në bazë të aktakuzës.

II. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT

A. Kompetenca e trupit gjykues të Gjykatës Themelore

Në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar çështjen e kompetencës dhe pasi që palët nuk kanë ngritur asnjë kundërshtim, kolegji mjaftohet si më poshtë.

Më 23 mars 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka marrë vendimin nr. 24/2015³ me të cilin e ka miratuar kërkesën që EULEX-i të vazhdojë me gjykimin në fjalë. Në arsyetimin e vendimit thuhet *“Kërkesa e EULEX-it për t’ia caktuar lëndën në fjalë trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it është justifikuar duke u bazuar në natyrën urgjente dhe shumë të ndjeshme të saj ...”* Më tej thuhet *“... konfirmohet se lënda e përmendur do të gjykohet nga gjyqtarë të EULEX-it ... dhe se çështja në fjalë konsiderohet si “lëndë në vazhdim”.*

Në përputhje me Ligjin mbi gjykatat si dhe me nenet 2 dhe 3 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 04/L-273), e po ashtu në pajtim me Marrëveshjen në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka pasur juridiksionin mbi lëndën në fjalë dhe se trupi gjykues i Gjykatës Themelore ka qenë kompetent për të vendosur në përbërje prej gjyqtarëve të EULEX-it.

B. Kompetenca e kolegjit të Gjykatës së Apelit

Nuk ka pasur kundërshtime nga palët. Në pajtim me nenin 472 (1) të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar çështjen e kompetencës së tij.

Siç u theksua edhe më lart, Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 23 mars 2015 e ka konfirmuar se lënda në fjalë është *“lëndë në vazhdim”*. Praktika gjyqësore në Kosovë ka vendosur për interpretimin sipas të cilit lënda e cila i është caktuar kolegjit me shumicë të EULEX-it ka vazhduar të shqyrtohet nga kolegji me shumicë të EULEX-it në të gjitha fazat e procedurës penale apo instancat gjyqësore deri në nxjerrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo praktikë është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe në Ligjin e ri mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës (Ligjin nr. 05/L-103), neni 3 i të cilit e riformulon nenin 1 A, par. 2 të Ligjit mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 – të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273, i cili thotë: *“Për qëllime të këtij ligji, çështjet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni konsiderohen çështjet në proces edhe për gjykatat në cilëndo fazë dhe instancë gjyqësore deri të një vendim*

³ Në përkthimet në anglisht dhe serbisht shkruan gabimisht “23/2015”

gjqësor i plotfuqishëm, përfshirë eventualisht edhe shqyrtimin në bazë të mjeteve të jashtëzakonshme juridike.”

Kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksion mbi çështjen në fjalë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur rreth lëndës në fjalë në përbërje prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari kosovar të apelit.

C. Pranueshmëria e ankesës

Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 10 dhjetor 2015. Aktgjykimi në formë të shkruar i është dërguar **R.K.** dhe mbrojtësit të tij më 12 janar 2016, ndërsa prokurorit të EULEX-it më 8 janar 2016. Ankesa është parashtruar brenda afatit prej 15 ditës në përputhje me nenin 380 (1) të KPP-së. Ankesa është parashtruar nga personi i autorizuar.

Ankesa përmban, së paku lidhur me disa prej pretendimeve, të gjitha informatat tjera në bazë të nenit 382 *et seq* të KPP-së. Për këtë arsye, ankesa është e pranueshme.

D. Gjetjet mbi çështjet meritore

Kolegji i apelit do t'i diskutojë të gjitha arsyet e ankesës të ngritura nën titujt përkatës në vazhdim.

Mbrojtja e ka kontestuar ankesën duke theksuar se ajo nuk përmban shpjegim të mjaftueshëm të shkeljeve të neneve 384 dhe 385 të KPP-së.

Sa i përket sqarimit të shkeljeve të pretenduara të procedurës penale në ankesë, në përputhje me nenin 384 të KPP-së, kolegji vëren se ankesa vërtet nuk e përmban një shpjegim të tillë. Kolegji nuk ka gjetur *ex officio* shkelje të tillë.

Sa i përket sqarimit të shkeljeve të pretenduara të ligjit penal në ankesë, në përputhje me nenin 385 të KPP-së, kolegji i referohet komentimit të ligjit penal⁴ në të cilin thuhet se “*Shkelja e Kodit Penal e përcaktuar në nenin 385, par. 1, nënpar. 1.4 e nënkupton zbatimin e gabueshëm të ligjit penal në gjendjen faktike të vërtetuar drejt. Me zbatim të gabueshëm të ligjit para së gjithash duhet të kuptohet cilësimi i gabueshëm i ligjit apo çfarëdo zbatimi tjetër të dispozitave ligjore materiale, përfshirë dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal,...*” Prandaj, nënparagrafi 1.4 i nenit 385 të KPP-së ka të bëjë me refuzimin e prokurorëve të klasifikimit ligjor të fakteve të

⁴ Me autorët Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati / Mr. Xhevdet Elshani, Komentari-Kodi i Procedurës Penale

provuara. Kolegji në vazhdim në mënyrë tematike do t'i diskutojë shkeljet e pretenduara të ligjit penal, të ngritura në paragrafët 4, 5 dhe 7 të ankesës.

Dashja e R.K. lidhur me gjuajtjet nga armët

Prokurori i EULEX-it, në ankesën e tij i referohet “tërësisë së provave” pa e veçuar asnjë provë të vetme individuale.

Kolegji thirret në nenin 15 (1) të KPK-së, i cili thotë: “*Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.*” Paragrafi 2 i këtij neni e shpjegon më tutje dashjen direkte “...kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.” Paragrafi 3 e shpjegon dashjen eventuale si “...kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.”

Gjykata Themelore e Mitrovicës ka pohuar, për shembull se “... nuk ka indikacione konkrete që **R.K** ka parë ndonjë person me armë duke shkuar kah vendi i krimit apo që ka dëgjuar ndokë duke folur apo duke dhënë urdhër të silleshin armët para se të ngrihej barrikada, as nuk është prezantuar asnjë provë konkrete për të treguar se **R.K** ka qenë bile edhe në dijeni se kishte persona të tjerë në pyll afër barrikadës.”⁵ Gjykata Themelore e Mitrovicës ka konstatuar se prokurori nuk e ka provuar dashjen e të pandehurit **R.K**.

Kolegji i apelit i ka lexuar të gjitha provat e përshkruara në aktgjykim⁶ e po ashtu edhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Përveç gjetjeve të cituara më lart, Gjykata Themelore e ka konsideruar si fakt se tashmë kishte qenë “një situatë e tendosur në terren”⁷ qysh para akteve të përshkruara në aktakuzë, dhe se një ditë më parë kishte pasur bllokim të rrugëve dhe sulme ndaj Policisë së Kosovës.

Kolegji e thekson se prokuroria ka pasur të drejtë kur e ka theksuar se ndalimi i kolonës në barrikadë ka qenë kusht esencial për vrasjen e policit E.Z dhe për rrezikimin e policëve të tjerë. Kolegji më tutje vëren se po të kishte pasur prova për ta lidhur të pandehurin qoftë me personat që kanë shtënë me armë zjarri mbi kolonë ose me planifikimin e pusisë, kolegji do ta kishte shpallur të pandehurin **R.K** penalisht përgjegjës edhe për vrasjen dhe vrasjet në tentativë. Megjithatë, kolegji është i mendimit se rrethanat faktike të prezantuara nuk janë të mjaftueshme për të konstatuar se **R.K** është dashur ta dijë pjesëmarrja në bllokimin e rrugëve do të rezultojë në gjuajtje me armë zjarri. Së pari, e tërë popullsia ishte thirrë përmes një sirene alarmuese që të dilnin në rrugët e tjera të bllokuara, sulmet e mëhershme mbi Policinë e Kosovës kishin qenë me

⁵ Aktgjykimi i apeluar, faqe 32

⁶ Aktgjykimi i apeluar, faqet 17 – 23

⁷ Aktgjykimi i apeluar, faqe 26

gurë dhe disa prej rrugëve të bllokuara ishin zhblokuar përmes negociatave dhe pa dhunë.⁸ Së dyti, barrikada në të cilën kishte dalë **R.K** ishte ngritur në momentin kur policia kishte arritur në vendin e ngjarjes dhe si përgjigje ndaj policisë e cila nuk ishte ndalur në barrikadën e parë që ishte më permanente.⁹ Së treti, sulmi nuk kishte filluar menjëherë. **R.K** dhe të tjerët kishin bërë titur dhe kishin bërë me gjeste në drejtim të policëve në mënyrë që ata të ktheheshin.¹⁰ Ashtu siç e ka vënë re, Gjykata Themelore “*Ka shumë gjasa që ata që e kishin organizuar operacionin kishin menduar se kolona do të ndalonte dhe do të kthehej për shkak të barrikadës.*”¹¹ Në fund, siç e ka theksuar Gjykata Themelore: “... kur personat në barrikadë janë larguar ... të gjithë përveç të pandehurit **R.K** ishin zhdukur pas kthesës së rrugës, përderisa **R.K** kishte zbritur poshtë në një kolektor të ujit në anën e majtë të rrugës nga 50 metra para.”¹² Të gjitha këto rrethana faktike e mbështesin konkluzionin se **R.K** nuk e kishte si qëllim të merrte pjesë në pusinë e paramenduar me synim vrasjen e policëve. Kolegji nuk ka mundur të gjejë asnjë provë të vetme për ta kontestuar konkluzionin në fjalë.

Prandaj, kolegji pajtohet me arsyetimin dhe vlerësimin e bërë nga Gjykata Themelore.

Ri-cilësimi

Kolegji e përsërit se është konstatuar se **R.K** “*ka bërë me gisht dhe ka bërë titur në drejtim të Policisë e Kosovës.*”¹³ Për dallim nga pretendimi i prokurorit të EULEX-it, kolegji i apelit nuk konstaton që veprimet e **R.K**. përbëjnë “dhunë apo kanosje për përdorim të atqashëm të dhunës” në bazë të (nenit 316, paragrafit 1 të KPK-së) ose “forcë apo kanosje serioze” (sipas nenit 409, paragrafit 1 të KPRK-së). Për këtë arsye, kolegji pajtohet me vlerësimin e bërë nga Gjykata Themelore.

Megjithëkëtë, kolegji i apelit vëren se emërtimi i saktë i veprës penale të përcaktuar me nenin 318 (1) të KPK-së është Pjesëmarrje në grup në pengimin e personave zyrtarë gjatë kryerjes së

⁸ Aktgjykimi i apeluar, faqe 29 dhe raporti përmbledhës i nxjerrë nga PK-ja mbi ngjarjet prej 25 deri më 27 korrik 2011, dosja e prokurorisë, faqet 169 – 172

⁹ Aktgjykimi i apeluar, faqe 24 “... kolona ka hasur në barrikadën e parë të bërë me gurë dhe me zhavorr. ... Kolona për këtë arsye ka shfrytëzuar një rrugë alternative...” dhe faqe 3 “... kolona e PK-së ka hasur në katër-pesë automjete të cilat po vinin nga drejtimi i kundërt. Këto automjete që po afroheshin janë ndalur dhe kanë krijuar një barrikadë ...”

¹⁰ Aktgjykimi i apeluar, faqe 3

¹¹ Aktgjykimi i apeluar, faqe 31

¹² Aktgjykimi i apeluar, faqe 32

¹³ Aktgjykimi i apeluar, faqe 36

detyrave zyrtare”. Për më tepër, Gjykata Themelore nuk e kishte treguar nënparagrafin por nga arsyetimi është e qartë se ata i referohen nënparagrafit 1. Kështu, kolegji në këtë drejtim e ka ndryshuar aktgjykimin *ex officio*.

Klasifikimi i gabueshëm i ‘rrezikimit’

Kolegji e thekson se lidhur me bllokimin e rrugës apo barrikadës, aktakuza i referohet “... në mes fshatrave Varage dhe Zupce të komunës së Zubin Potokut...”¹⁴ Më tutje, Gjykata Themelore ka konstatuar se “... *katër-pesë automjete kanë qenë duke ardhur nga drejtimi i kundërt. Këto automjete që po afroreshin janë ndalur dhe kanë krijuar një barrikadë e cila e ka bllokuar rrugën dhe e ka detyruar kolonën e PK-së që të ndalej.*”¹⁵ Dëshmitari E. D. , i cili ka qenë duke e vozitur automjetin e parë në kolonën e PK-së, në dëshminë e tij ka deklaruar se “*Ka qenë në mesin e rrugës ndërsa dy automjete po vinin në drejtim timin dhe unë e kam ngadalësuar automjetin e blinduar dhe ne jemi ndalur duke pasur një distancë prej 50 – 100 metrash në mes nesh, por nuk jam i sigurt.*”¹⁶

Kolegji pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se formimi i barrikadës në këto kushte, nuk ka paraqitur rrezik konkret (të vërtetë) apo abstrakt (të mundshëm).

Interpretimi i gabuar i ‘turmës’

Kolegji e thekson që Gjykata Themelore e ka konstatuar të provuar “...*se kanë qenë së paku 6 persona në barrikadë, porse ka mundësi të kenë qenë më tepër*” duke vazhduar se “... *numri i saktë i pjesëmarrësve në barrikadë në asnjë mënyrë nuk ka karakter vendimtar kur kemi të bëjmë me çështjen e fajit ...*”¹⁷ Gjykata Themelore më tutje e shpjegon se aktivitetet e të pandehurit **R.K** – britma dhe gjestet në drejtim të policëve për t’u kthyer¹⁸ - nuk i plotësojnë kushtet e “disa krimeve të rënda” siç përshkruhet në nenet 320 të KPK-së dhe 412 të KPRK-së.

Kolegji pajtohet me këtë gjetje të Gjykatës Themelore.

Dënimi

¹⁴ Aktakuza, faqe 8

¹⁵ Aktgjykimi i apeluar, faqe 3

¹⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 26 tetor 2015, faqe 24, versioni në anglisht

¹⁷ Aktgjykimi i apeluar, faqe 25

¹⁸ Aktgjykimi i apeluar, faqe 3

Sa iu përket faktorëve lehtësues, kolegji e përsërit që Gjykata Themelore ka konstatuar se **R.K** ka qenë “shumicën e kohës” në arrati derisa lënda ishte në pritje. Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se Gjykata Themelore me të drejtë e ka theksuar se pasi që vonesa e procedurës ka qenë si pasojë e veprimeve të të pandehurit, atëherë vonesa në fjalë ka një “peshë të kufizuar”.

Lidhur me rrethanat rënduese, kolegji e përsërit se ashtu siç parashihet me KPRK, me nenin 3, ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale do të zbatohet ndaj kryerësit në qoftë se ligji i ri nuk është më i favorshëm. Pasi që trupi gjykues i Gjykatës Themelore me të drejtë e ka vlerësuar se KPRK nuk është më i favorshëm për të pandehurin sesa KPK, atëherë KPK aplikohet edhe për rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Neni 64 i KPK-së nuk përmban ndonjë listë të detajuar të rrethanave rënduese siç përmenden në nenin 74 të KPRK-së. Prandaj, pretendimi i prokurorit se trupi gjykues nuk e ka zbatuar nenin në fjalë është pretendim i heshtur, sepse nuk mund të përzihen të dyja kodet. Megjithatë, si përgjigje ndaj arsytimit të prokurorit, kolegji vëren se “*tregimi i gishtit dhe bërtitja në drejtim të PK-së*”¹⁹ të cilën i pandehuri **R.K** është konstatuar se e ka bërë nuk përbën “prani të dhunës së vërtetë apo dhunës së kanosur për kryerjen e veprës penale”. Më tutje, kolegji vëren se shënjestër e vërtetë e barrikadës nuk kanë qenë individët që e përbënin kolonën *per se* por institucioni të cilin ata e përfaqësonin (Policia e Kosovës) si dhe pozita e tyre në këtë institucion (policë). Për këtë arsye, kolegji është i mendimit se është i pavend kriteri “viktima të shumta”. Po ashtu, kolegji vëren se *ratio legis* i motiveve entike si faktor rëndues është që t’i mbrojë individët e jo institucionet shtetërore. Për këtë arsye, kolegji është i mendimit se në rastin e aktiviteteve të të pandehurit **R.K** nuk vlen kriteri rëndues për shkak të shënjestrimit të “përkatësisë etnike apo kombëtare, kombësisë, gjuhës, besimit fetar apo mungesës së besimit fetar, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, apo për shkak të lidhjes me personat të cilët i kanë karakteristikat e përmendura më lart.”

Megjithatë, kolegji i apelit është i mendimit se trupi gjykues i Gjykatës Themelore nuk i ka dhënë peshën e duhur qëllimit të dyfishtë të dënimit siç kërkohet me nenin 34 (1.2) të KPK-së, ku thuhet se “*Qëllimet e dënimit janë: ... t’i dekurajojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.*” Ky dekurajim e merr parasysh interesin e shoqërisë. Kolegji i apelit e përsërit frekuencën e sjelljes obstruktive të përshkruar në aktakuzën e asaj kohe, dhe vëren se kjo sjellje vazhdon edhe tani. Kolegji më tutje e pranon se kjo sjellje i bën dëm shoqërisë dhe e thekson se nuk duhet të tolerohet. Kolegji në vazhdim është i mendimit se për të arritur një efekt të vërtetë të dekurajimit të përgjithshëm me qëllim parandalimi të personave të tjerë nga kryerja e veprave të ngjashme, ka nevojë për një dënim më të gjatë me burgim. Për më tepër, me qëllim të parandalimit të të pandehurit **R.K** nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, më proporcionale është një periudhë më e gjatë e dënimit me kusht, duke e pasur parasysh seriozitetin e veprës penale si dhe pasojat e rënda në raport me veprën për të cilën i pandehuri në fjalë është konstatuar se bart përgjegjësi penale.

¹⁹ Aktgjykimi i apeluar, faqe 36

Kompensimi i shpenzimeve të procedurës

Kolegji i apelit e thekson se Gjykata Themelore ka konstatuar se “... duke e pasur parasysh gjendjen e paqëndrueshme familjare, shqiptimi i pagesës së plotë do ta rrezikonte mbështetjen financiare të gruas dhe fëmijëve të të pandehurit.” Ashtu siç e ka theksuar Gjykata Themelore, në bazë të nenit 453 (4) të KPP-së “Në vendimin me të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompensimit, në tërësi ose pjesërisht, të shpenzimeve të procedurës penale ... nëse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t’i mbështesë materialisht”

Prandaj, kolegji i apelit konstaton se vendimi i Gjykatës Themelore mbi kompensimin e shpenzimeve është vendim i drejtë.

III. KONKLUZION

Gjykata e Apelit, për arsyet e shtjelluara më lart, e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën mbi dënimin, e korrigjon *ex officio* emërtimin e veprës penale dhe e fut *ex officio* numrin e nënparagrafit në kuadër të dispozitivit. Sa i përket pjesës tjetër, Gjykata e Apelit e refuzon ankesën e prokurores së EULEX-it dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar.

Hartuar në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më 8 gusht 2016.

Kryetarja e kolegjit

—————
Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtari i kolegjit

Xhevdet Abazi
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Radostin Petrov
Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën e Apelit

Procesmbajtëse

Noora Aarnio
Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 147/16
4 gusht 2016